

LIGJ
Nr.7608, datë 22.9.1992

PËR PREFEKTURAT

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Për të bashkërenduar veprimtarinë e ministrive e të institucioneve të tjera qendrore në njësitë administrativo-tokësore, si dhe për të kontrolluar ligjshmërinë e akteve që nxjerrin organet e pushtetit lokal, krijohen prefekturat. Numri, shtrirja territoriale dhe qendra e tyre caktohet nga Këshilli i Ministrave.

Neni 2

Titullari i prefekturës është prefekti.

Prefekti është përfaqësues i qeverisë në planin lokal. Ai emërohet dhe shkarkohet nga Këshilli i Ministrave.

Që një person të emërohet prefekt, duhet të ketë kryer arsimin e lartë dhe të ketë mbushur moshën 30 vjeç.

Neni 3

Prefekti nuk mund të jetë deputet, anëtar i këshillave të komunave, bashkive ose të rretheve. Ai nuk duhet të ketë asnjë funksion tjetër të pagueshëm publik a profesional ose të bëjë pjesë në shoqëri a institucione me karakter privat fitimprurës.

Neni 4

Prefekti mbikëqyr veprimtarinë ligjore të organeve të pushtetit lokal, në mënyrë që ajo të kryhet në përputhje me ligjet.

Ndërmjet prefektit dhe organeve të pushtetit lokal nuk ka marrëdhënie vartësie.

Neni 5

Prefekti ka këto kompetenca kryesore:

1. Siguron mbrojtjen e interesave shtetërore, si dhe respektimin e ligjeve e të akteve nënligjore.

2. Mbikëqyr ligjshmërinë e akteve që nxirren nga organet e pushtetit lokal.

3. Kujdeset për zhvillimin ekonomik, shoqëror, arsimor e kulturor të prefekturës.

4. Vendos emërimin ose shkarkimin e personelit të administratës së prefekturës.

5. Mbikëqyr veprimtarinë e organeve të ruajtjes së rendit dhe u bën sugjerime atyre.

6. Përgjigjet, në kushtet e parashikuara me ligj, për përgatitjen dhe plotësimin e masave mbrojtëse me karakter joushtarak. Organet ushtarake dhe ato të ruajtjes së rendit janë të detyruara të njoftojnë prefektin për çdo problem të rëndësishëm të prefekturës.

7. Përgjigjet para Këshillit të Ministrave për gjendjen e përgjithshme ekonomike, sociale, kulturore dhe administrative të prefekturës.

Prefekti kryen, gjithashtu, edhe detyra të tjera që i ngarkohen me ligj ose me akte të Këshillit të Ministrave.

Kur ministri dhe drejtuesit e institucioneve qendrore nuk janë të një mendimi me urdhrat e dhëna nga prefekti për organet e tyre në prefekturë, çështja zgjidhet nga Kryetari i Këshillit të Ministrave.

Neni 6

Organet e pushtetit lokal janë të detyruara të njoftojnë prefektin për aktet e nxjerra prej tyre brenda 10 ditëve nga dita e miratimit të aktit.

Prefekti duhet të shprehet për ligjshmërinë e aktit brenda 10 ditëve nga dita që është njoftuar.

Kur prefekti vëren që një akt i nxjerrë nga organet e pushtetit lokal është i paligjshëm, ka të drejtë ta dërgojë atë në gjykatë. Në këtë rast pezullohet zbatimi i aktit.

Neni 7

Për kryerjen e kompetencave të tij prefekti nxjerr urdhëra dhe vendime.

Urdhërat që parashikojnë masa me karakter të veçantë, nxirren pas këshillimit paraprak me organet e specializuara dhe kundërfirmosen nga drejtuesit e tyre.

Neni 8

Urdhërat e prefektit kanë karakter normativ, bëhen të zbatueshëm pas shpalljes së tyre me mjetet e informimit publik, kurse për raste të tjera nga data e njoftimit të tyre.

Neni 9

Prefekti ka kabinetin e tij, të përbërë nga specialistë të fushave të ndryshme, struktura dhe detyrat e të cilit caktohen me akte të Këshillit të Ministrave.

Neni 10

Në çdo prefekturë krijohet këshilli administrativ.

Këshilli administrativ përbëhet nga prefekti, që është edhe kryetar i tij, kryetarët e këshillave të rretheve dhe nga drejtuesit e organeve që varen nga ministrinë e institucionet e tjera qendrore.

Neni 11

Këshilli administrativ mbledhet një herë në 3 muaj ose edhe më parë, kur e çmon të nevojshme prefekti.

Debatet që zhvillohen në mbledhjen e këshillit administrativ mund të ndiqen nga kryetarët e këshillave të komunave e bashkive, si dhe nga persona të tjerë të ftuar.

Neni 12

Këshilli administrativ përgatit një program vjetor për veprimtaritë kryesore të prefekturës, i cili u njoftohet organeve të pushtetit lokal dhe drejtuesve të organeve që varen nga ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore.

Neni 13

Kompetencat e këshillit administrativ caktohen me dispozita të veçanta.

Këshilli administrativ merr vendime me votim të hapur, të cilat nënshkruhen nga prefekti dhe janë të detyrueshme për organet e institucionet që varen nga ministritë e institucionet e tjera qendrore. Vendimet e këshillit administrativ vihen në zbatim nga kabineti i prefektit.

Neni 14

Pika 13 e nenit 45 të ligjit nr.7572, datë 10.6.1992 "Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal", shfuqizohet.

Neni 15

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.334, datë 9.12.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha